



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:278098

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05752955

KE.nr.1009/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Nic Construction” SH.P.K., me NUI:810727886, me seli në Graçanicë, Çagllavicë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër të paditurit “Arbon AD” SH.P.K., me NUI:811488411, me seli në Shtërpçë, fshati Biti e Epërme, me objekt kontesti lirim i vikendshtëpisë dhe dorëzim në posedim, jashtë seancës më datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë të paditësit “Nic Construction” SH.P.K., me numër të lëndës KE.nr.1009/23 (2023:278098) të datës 13.12.2023, kundër të paditurit “Arbon AD” SH.P.K., me objekt kontesti lirim i vikendshtëpisë dhe dorëzim në posedim.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi “Nic Construction” SH.P.K., me seli në Graçanicë më datë 13.12.2023, përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditësit ashtu që te detyrohet i padituri që paditësit t’ia paguaj borxhin

e mbetur me kamat ligjore 8% në vit, ose të detyrohet i padituri që paditësit t’ia liroj nga sendet dhe njerëzit si dhe t’ia dorëzoj në posedim vikendshtëpizën në sipërfaqes prej 125 m<sup>2</sup> të ndërtuar nga paditësi në një pjesë te ngastrës kadastrale Nr.6423-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 272 m<sup>2</sup> në kompleksin “Nic Brezovicë”, në vendin e quajtur Treshnja, komuna e Shtërpcës, si dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*.

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me një kontest, lidhur me lirim të paluajtshmërisë, andaj kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, kjo bazuar në nenin 13, par.1, nën par.1.6 dhe 1.7 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.6. “Kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare”, 1.7. “kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*, lidhur me paragrafin 3 *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.6, 1.7, 1.8, 1.10 dhe 1.13 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti i Përgjithshëm*

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1009/23, datë 29.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate